

AKTI I THEMELIMIT

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BALKANWIDE ASSISTANCE & SERVICES” SH.P.K

Sot, në Tiranë, më datë 24.05.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), personat e mëposhtëm:

1. **Irsa Raça**, atësia Sokol, datëlindja 21.04.1996, lindur dhe banuese në Tiranë, rruga “Sami Frashëri” P 17/3/29, titullare e letërnjoftimit me nr. 031735185 dhe nr. personal J65421044S;
2. **Predrag Matic**, datëlindja 26.02.1985, lindur në Francë, banues në adresën Jovanicka 4, në Beograd, numri amzës 2602985770066, numri i pasaportës 18FK97084, lëshuar nga Ambasada Franceze ne Beograd.
3. **Ninko Petar Matic**, datëlindja 12.07.1990, lindur në Francë, banues në Jovanicka 4, ne Beograd, titullar i pasaportës me nr. 13AV87441, lëshuar nga Ambasada Franceze ne Beograd, madhorë, me zotësi të plotë juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, të cilët themelojnë shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “**BALKANWIDE ASSISTANCE & SERVICES**” SH.P.K dhe hartojnë për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë me përmbajtje si vijon:

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

1. Emërtimi i shoqërisë është “**BALKANWIDE ASSISTANCE & SERVICES**” SH.P.K.

NENI 2

2.1 Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht në Ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe për këtë qëllim hartojnë Aktin e Themelimit të tij, me përmbajtjen si vijon:

NENI 3

FORMA

3.1 Shoqëria “**BALKANWIDE ASSISTANCE & SERVICES**” SH.P.K, është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

NENI 4

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, rruga “Sami Frashëri”, pallati 17, shk. 3, ap. 29.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:



- Import eksport i te gjitha mallrave dhe sherbimeve
- Makina ne shitje
- Shitje e pjeseve dhe pajisjeve te automjeteve
- Transport i mallrave ne rruge tokesore
- Transport i personave ne rruge tokesore
- Shërbime ne trafikun rrugor
- Aktiviteti i operatoreve turistik ose agjensive te udhëtimit
- Aktiviteti i ndërmjetësve te tjerë te trafikut
- Lokalizimi i makinave dhe motorave
- Lokalizimi i automjeteve te tjera rrugore
- Sigurimi i këshillave per programuesit kompjuterik dhe aplikacioneve
- Perpunim i te dhënave
- Krijimi i bazës se te dhënave
- Kerkim i tregut dhe investigimi i opinionit publik
- Konsultimi dhe menaxhimi

NENI 6

6.1 Kohëzgjatja e shoqërise do të jetë mbi 10 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos asambleja e ortakëve.

NENI 7 TERRITORI

7.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, degë, ose përfaqësi në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 8 KAPITALI DHE PJESËT

8.1 Kapitali i shoqërise ka vlerën 300 000 (treqindmijë) lekë, i cili ndahet në 3 kuota. Vlera e kapitalit të shoqërisë është tërësisht i rimbursueshëm me kontributin e ortakëve sipas raportit të ortakëve.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme (parashikuar në statutin e shoqërisë). Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.3 Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të jashtëzakonshme (parashikuar në statutin e shoqërisë). Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

M. Maunth



NENI 9 KONTRIBUTET

9.1 Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortakët e shoqërisë, **Irsa Raça, Predrag Matic** dhe **Ninko Petar Matic**, si vijon:

9.2 Ortaku **Irsa Raça** zotëron një kuotë baraz me 30 % (tridhjetë përqind) të të gjithë vlerës së kapitalit, me vlerë totale prej 90 000 lekë (nëntëdhjetëmijë).

9.3 Ortaku **PREDRAG MATIC**, zotëron një kuotë baraz me 35 % (tridhjetë e pesë përqind) të të gjithë vlerës së kapitalit me vlerë totale prej 105 000 lekë (njëqind e pesëmijë).

9.4. Ortaku **Ninko Petar Matic**, zotëron një kuotë baraz me 35 % (tridhjetë e pesë përqind) të të gjithë vlerës së kapitalit me vlerë totale prej 105 000 lekë (njëqind e pesëmijë).

9.5 Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

9.6 Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

NENI 10

10.1 Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mesipërme, për të cilin do të nevojitet leje përkatëse, shoqëria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

NENI 11 ADMINISTRIMI

11.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.


11.2 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.

11.3 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

11.4 Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

NENI 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

12.1 Administratorëve iu njihet e drejta për të ushtruar të gjitha kompetencat për kryerjen e veprimeve të administrimit dhe të përfaqësimit në emër të shoqërisë, në interes të saj dhe nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e Shoqërisë, Principet e Biznesit dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti i japin shprehimisht ortakëve.



NENI 13
EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

13.1 Administrator i parë i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet **Irsa Raça**, atësia Sokol, datëlindja 21.04.1996, e regjistruar me nr. personal J65421044S.

Akti i Themelimit u përpilua në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale, duke pasur të gjitha fuqitë ligjore të barabarta për t'u administruar sipas ligjit.

I pranishem në nënshkrimin e akteve përkthyesi zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë, z. **Gert Kodra**, i datëlindjes 21.05.1974, i regjistruar me nr personal H40521141M

ORTAKËT THEMELUES

Irsa Raça

Irsa Raça


Predrag Matic

PREDRAG MATIC


Ninko Petar Matic

NINKO PETAR MATIĆ
M. Matic

I pranishem përkthyesi Gert Kodra

GERT KODRA
